



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO  
Hajvali - Prishtinë



REPUBLIKA E KOSOVËS  
QEVERIA

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë

Nr / Br. 04-052-093/1

Data / Datum 05-07-2024

Referencë: **IPK/05072024/DI**

Datë: **05.07.2024**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektive në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, si dhe Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), Departamenti i Inspektiveve të IPK-së nxjerrë këtë:

### RAPORT I INSPEKTIMIT

<b>Titulli - objekti</b>	- Vlerësimi i menaxhimit të procesit të gradimit për rreshter
<b>Referenca</b>	- 02/2024
<b>Data e inicimit</b>	- 13.05.2024
<b>Data e raportimit</b>	- 05.07.2024
<b>Arsyet e inicimit</b>	- Me kërkesë të Departamentit të Hetimeve të IPK-së, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Kushtrim Hodaj ka autorizuar Departamentin e Inspektimit të IPK-së që të realizojë një inspektim të jashtëzakonshëm në Departamentin e Burimeve Njerëzore të Policisë së Kosovës, duke përfshirë edhe Drejtorinë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës, për të vlerësuar respektimin e rregullave e procedurave të procesit të fundit të gradimit të zyrtarëve policor për gradën Rreshter. Kërkesa për këtë inspektim ka pasqyruar shqetësimet mbi numrin e madh të ankesave të adresuara në IPK lidhur me rregullsinë e procesit të gradimit. Ankesat kanë ngritur dyshime në respektimin e kriterëve të aplikimit, integritetin e procesit dhe organizimin e testimit. Inspektimi është fokusuar tek analiza e nevojave, respektimi i parimeve të trajtimit të barabartë të palëve, aplikimi dhe testimi, vendimmarrja, transparenca dhe trajtimi i ankesave. Përmes inspektimit është synuar të vlerësohet integriteti i procesit dhe të hidhet dritë mbi rregullsinë e tij.
<b>Objektivat e inspektimit</b>	- Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave të gradimit, - Vlerësimi i integritetit të procesit të aplikimit dhe testimit.
<b>Metodologjia e inspektimit</b>	- Gjatë realizimit të punës inspektuese është aplikuar metodologjia, si: a) Janë realizuar takime - intervista me bartësit e funksioneve, si: - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, - Drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore, - Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë, - Drejtori i Drejtorisë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës, - Kryesuesi i Komisionit të procesit të gradimit; b) Janë siguruar dhe verifikuar dokumente, apo të dhëna në formë fizike dhe elektronike, përfshirë dhe pjesë të dosjes së gradimit, si: - Analiza e nevojave për personel të graduar, - Kërkesa për shpalljen e procesit të gradimit për gradën Rreshter, - Shpallja e konkursit, - Vendimet për Komisionin e procesit të gradimit dhe panelet, - Listat e aplikimit, pjesëmarrësve në testim dhe rezultateve të testimit,

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Lista e të punësuarve në pesë (5) vitet e fundit sipas gjeneratave,</li> <li>- Njoftimi mbi mbajtjen e testimit me shkrim, përfshirë dhe Listën,</li> <li>- Lista me 1.100 pyetje për procesin e gradimit, si dhe testet A dhe B,</li> <li>- Lista e ankesave, ankesat dhe vendimmarrja,</li> <li>- Format e pranimit - dorëzimit të materialeve të testimit.</li> <li>- Raportet e Komisionit dhe paneleve mbi procesin e testimit,</li> <li>- Informata nga 28 mostra të dosjeve të aplikantëve të gjeneratës 54-të.</li> </ul>
<b>Subjekti</b>	- Departamenti i Burimeve Njerëzore, përfshirë dhe Drejtorinë e Zhvillimit të Performancës dhe Karrierës, si dhe Komisioni për procesin e gradimit.
<b>Afatet e inspektimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fillimi i inspektimit: 13.05.2024,</li> <li>- Përfundimi: 21.05.2024,</li> <li>- Periudha e mbulimit - Faza gjatë së cilës është zhvilluar procesi i gradimit.</li> </ul>
<b>Kriteri vlerësues (standardi)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë,</li> <li>- UA Nr. 02/2019 për Procedurën e Gradimit për Zyrtarët Policor,</li> <li>- PSO për Gradim në Policinë e Kosovës Nr. PSO-07DP-06 (datë 12.12.19),</li> <li>- Analiza e nevojave për Personel të Graduar në Policinë e Kosovës.</li> </ul>
<b>Ekipi realizues</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtrim Jonuzi, inspektor,</li> <li>- Xhavit Fetahaj, inspektor.</li> </ul>
<b>Mbikëqyrur nga</b>	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
<b>Mbështetur nga</b>	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
<b>Dorëzuar nga</b>	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miratuar nga</b>	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i JPK-së*
<b>Datë</b>	- 05.07.2024



**Shkurtesat**

<b>DBF</b>	<b>Drejtoria për Buxhet dhe Financa</b>
<b>DBNJ</b>	<b>Departamenti i Burimeve Njerëzore</b>
<b>DZHRK</b>	<b>Drejtoria për Zhvillim të Performancës dhe Karrierës</b>
<b>IPK</b>	<b>Inspektorati Policor i Kosovës</b>
<b>LPA</b>	<b>Lista e Personelit të Autorizuar</b>
<b>MPB</b>	<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>
<b>PSO</b>	<b>Procedura Standarde e Operimit</b>

## Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet


### Inspektimi nxjerrë në pah se:

- ✦ *Procesi i gradimit është përcjellur me disa dobësi në fazën e konkurrimit, si rezultat i të cilave janë ngritur shumë shqetësime dhe ankesa lidhur me këtë proces.*
- ✦ *Vihet në pah nevoja e rishikimit të bazës ligjore aktuale, duke marrë parasysh nevojën e harmonizimit të Udhëzimit dhe Programit të trajnimit themelor, si dhe respektimit të kriterëve të aplikimit,*
- ✦ *Respektimi i kriterit etnik gjatë krijimit të paneleve vlerësuese duhet të merret parasysh varësisht prej proceseve të gradimit dhe pjesëmarrjes së kandidatëve nga etnitë tjera. Mbarëvajtja e testimit nuk ka evidentuar ndonjë dobësi përveç nevojës për përgatitje më cilësore të procesit sa i përket aspektit teknik.*



### Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. *IPK i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të rishikojë harmonizimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019 për Procedurën e Gradimit për Zyrtarët Policor, me periudhën e realizimit të trajnimit themelor, duke qartësuar edhe rrugëtimin e personelit nga grada “kadet” deri në gradën “polic i lartë”.*
2. *IPK i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës që në të ardhmen gjatë përgatitjes së shpalljeve të konkurseve për këtë gradë, të përfshijë edhe kohën e qëndrimit minimal në gradë në mesin e kriterëve të aplikimit, drejt respektimit të plotë të kërkesave të Udhëzimit.*
3. *IPK i rekomandon Drejtorit të Divizionit të Personelit dhe Administratës që të përkujdeset në aspektin administrativ për kalimin me kohë të zyrtarëve policor nga grada kadet deri në gradën polic i lartë, duke respektuar afatet e parapara me Udhëzimin.*
4. *IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore që të sigurohet se sistemi PRIMS aplikon masat kufizuese për filtrimin e aplikimeve që nuk plotësojnë kriteret për t’iu nënshtruar proceseve të gradimit. Në raste kur aplikimet kryhen në mënyrë fizike, të sigurohet se ndiqen rregullat e aplikimit, përfshirë dhe shqyrtimin dhe verifikimin e historikut disiplinor dhe penal të kandidatëve.*
5. *IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore që të sigurohet se në proceset e gradimit respektohet parimi i përfshirjes në panele edhe të anëtarëve nga radhët e komuniteteve tjera etnike.*
6. *IPK i rekomandon Kryesuesit të Komisionit të procesit të gradimit dhe Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës që në të ardhmen të sigurohen që kandidatët gjatë aplikimit të kenë të kryer vlerësimin e performancës, si një nga pikat e vlerësimit brenda procesit të gradimit.*
7. *IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore, Kryesuesit të Komisionit të procesit të gradimit që të sigurohet se anëtarët e paneleve vlerësuese kuptojnë detyrat lidhur me procesin e testimit me shkrim, si dhe kanë njohuri të nevojshme për plotësimin e evidencave lidhur me materialet e testimit (formularët).*
8. *IPK i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të ndërmarrë veprime për të evituar çfarëdo dobësie apo lëshimi në këtë proces të gradimit, duke e konsideruar këtë raport si pasqyrues të gjetjeve që mund të kenë dëmtuar kredibilitetin e mbarëvajtjes së procesit në fjalë.*

<p><b>Gjetjet kryesore:</b></p> 	<p><b>1. Vlerësim i respektimit të rregullave dhe procedurës së gradimit</b></p> <p>1.1. Në vazhden e inspektimit të procesit të fundit të gradimit për rreshter, IPK-ja ka identifikuar bazën ligjore, e cila përcakton rregullat dhe procedurat e gradimit për zyrtarët policor. Konform nenit 55 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019 për procedurën e gradimit për zyrtarët policor <i>(në tekstin e mëtejme Udhëzimi)</i>. Në drejtim të detajimit të veprimeve dhe hapave që duhet ndjekur në proceset e gradimit, Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore ka miratuar Procedurën Standarde të Operimit për gradim në Polici të Kosovës<sup>1</sup> <i>(në tekstin e mëtejme PSO)</i>. Rregullat, procedurat, kriteret dhe veprimet e përcaktuara me këto dy dokumente kanë shërbyer si bazë, në të cilën është mbështetur vlerësimi i këtij procesi të gradimit.</p> <p>1.2. Neni 1, paragrafi 2 i Udhëzimit përcakton që gradimi i zyrtarëve policor është proces, që do të jetë i bazuar në nevojat e Policisë (pozitat e lira), si dhe me qëllimin e përzgjedhjes së pjesëtarëve më të kualifikuar nëpërmjet një procesi të drejtë dhe konkurrues. Në fund të vitit të kaluar, Policia ka shprehur interesimin për plotësimin e pozitave të lira për gradën rreshter. Pas identifikimit të nevojave për personel të graduar, më 10.11.2023, DZHPK ka kërkuar nga DBF që të konfirmoj nëse ka mjete të mjaftueshme për fillimin e procesit të gradimit për 350 pozita të lira për rreshter. Pasi ka siguruar disponueshmërinë e mjeteve të nevojshme, DBF më 14.11.2023 ka konfirmuar se mund të fillohet me procedurat për gradimin. Më pas, më 24.11.2023, DBNJ i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë, fillimin e procesit të gradimit në gradën rreshter, bazuar në identifikimin dhe analizën e nevojave<sup>2</sup>. Aprovimin për fillimin e këtij procesi e ka marrë Drejtori i Përgjithshëm i Policisë<sup>3</sup> më 27.11.2023. Në janar të këtij viti, DBNJ ka analizuar edhe njëherë nevojat për pozitat e lira, duke vlerësuar se janë 355 rreshter më pak se që parashihet me Strukturën dhe LPA-në.</p> <p>1.3. Më 09.02.2024, DZHPK ka shpallur procesin e gradimit për gradën përkatëse duke përfshirë mes tjerash edhe numrin e vendeve të lira, kriteret e aplikimit, afatet, të dhëna mbi procesin e testimit, rregullat e konkurrimit, referencat e materialit për testim, etj. Më 12.02.2024, DZHPK ka publikuar shpalljen për procesin e gradimit, duke lejuar konkurrimin elektronik<sup>4</sup>, por edhe atë fizik, në pamundësi të aplikimit të atij elektronik. Sa i përket kriterëve të aplikimit, shpallja ka përcaktuar se të drejtën për t'iu nënshtruar këtij procesi e kanë: të gjithë zyrtarët policor me të kaluarën prej minimum 5 vjet në shërbim duke përfshirë dhe kohëzgjatjen e trajnimit themelor për zyrtarë policor, dhe zyrtarët ndaj të cilëve nuk është shqiptuar masë disiplinore për shkelje të rëndë disiplinore apo vepër penale. Edhe pse këto kriteret i parasheh edhe Udhëzimi në nenin 13, shpallja nuk ka përfshirë plotësisht kriteret e Udhëzimit. E drejta e aplikimit iu është ofruar edhe kandidatëve që nuk kanë pasur gradën “polic i lartë”, të paraparë me paragrafin 2 dhe që nuk kanë përmbushur periudhën dy (2) vjeçare të qëndrimit në këtë gradë, siç parashihet në paragrafin 3.1 të të njëjtit nen.</p> <p>1.4. Sipas të dhënave nga dosja e gradimit mësohet se në këtë proces kanë aplikuar gjithsej 2.344 aplikantë, përfshirë ata që kanë aplikuar në mënyrë elektronike dhe fizike. Sipas menaxhmentit, <i>në rastet e aplikimit elektronik, të dhënat e kandidateve në proces janë në sistem dhe në formë automatike gjenerohen për secilin kandidat, dhe aplikimi është i lehtë dhe bëhet me vetëm një klikim</i>. Sipas të njëjtëve, <i>moduli i gradimit ka masa të sigurisë sipas kriterëve të përcaktuara për procesin e gradimit, si koha e qëndrimit në gradën paraprake, apo kufizimeve sa i përket fushës së</i></p>
---	--

<sup>1</sup> PSO-07DP-06.

<sup>2</sup> Kërkesa për fillimin e procesit të gradimit në gradën rreshter, DDBN-10/174/2023, datë 24.11.2023

<sup>3</sup> Kapitulli V - Procedurat, A. Shpallja e procesit të gradimit, pika 3 të PSO-së

<sup>4</sup> Konkurrimi elektronik ishte aplikuar edhe në dy procese paraprake të gradimit për toger dhe kapiten, andaj edhe ishte sugjeruar nga Drejtori i Divizionit për Personel e Administratë, që si mundësi aplikimi e bazuar në Udhëzim, të aplikohet edhe në këtë proces të gradimit.

<p><i>disiplinës dhe sistemi vetvetiu mund të parandalojë aplikimin e rasteve kur kandidati nuk plotëson kriteret e aplikimit.</i><sup>5</sup> Meqenëse procesit të gradimit kishte shprehur interesim t'i nënshtrohet edhe një numër i madh zyrtarësh policor, të cilat nuk kishin kaluar minimumin prej dy (2) vitesh të qëndrimit në gradën "polic i lartë", sistemit të konkurrimit elektronik i janë hequr masat e sigurisë lidhur me kriteret e aplikimit duke lejuar aplikimin edhe të shumë zyrtarëve tjerë nga gjenerata e 54-të e Policisë së Kosovës dhe jo vetëm, në kundërshtim me kriteret e aplikimit të parapara me Udhëzim. Si rezultat i heqjes së këtyre filtrave brenda sistemit, shumë kandidatë duke mos plotësuar këtë kriter, janë përfshirë në garën e testimit me shkrim.</p> <p>1.5. Më 19.04.2024, DZHPK ka publikuar Njoftimin për testin me shkrim për gradën rreshter, bashkë me Listën prej 2.230 kandidatëve për testin me shkrim për gradën rreshter. Nga kontrolli i Listës vërehet se fazës së testimit me shkrim iu është lejuar pjesëmarrja edhe 344 kandidatëve nga 382 sa ka pasur gjenerata e 54-të, të cilët edhe pse kanë pasur nga pesë (5) vite shërbim në organizatë, nuk kanë përmbushur kriterin e Udhëzimit lidhur me qëndrimin prej dy (2) vite në gradën "polic i lartë". Kjo situatë ka ngritur mospajtime në radhët e shumë kandidatëve, që me ankesat e tyre edhe kanë atakuar procesin. Në mesin e kandidatëve të kësaj gjenerate, ka pasur edhe nga ata që kanë pasur gradën aktuale "polic" apo "polic i ri".<sup>6</sup> Në këtë proces të gradimit ka marrë pjesë 90% e zyrtarëve policor të gjeneratës së 54-të, apo 15.4% e Listës së kandidatëve që i janë nënshtuar testimit me shkrim.</p> <p>1.6. Sipas nenit 4 të Udhëzimit, me propozim të Drejtorit të DBNJ-së më 13.03.2024, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka krijuar Komisionin për procesin e gradimit në përbërje prej nëntë (9) anëtarësh, njëri prej të cilëve si Kryesues i tij. Me vendimet e datës 30.04.2024 dhe 03.05.2024, ky Komision ka pësuar ndryshime në përbërje, si rezultat i deklarimit të konfliktit të interesit nga disa prej anëtarëve. Ky Komision ka përmbushur kërkesat ligjore sa i përket përbërjes etnike dhe gjinore të paraparë me nenin 5, paragrafi 1 të Udhëzimit. Përbërja e anëtarëve përmbushë edhe kriterin tjetër sipas të cilit, ata duhet të kenë së paku një gradë më të lartë se zyrtari policor që i nënshtrohet procesit të gradimit.</p> <p>1.7. Sipas nenit 11 të Udhëzimit, për të gjitha fazat e testimit krijohen panelet vlerësuese nga Drejtori i DBNJ-së. Bazuar në këtë më 03.05.2024 janë themeluar gjashtë (6) panele për testin me shkrim për gradën rreshter<sup>7</sup>. Panelet e krijuara është vlerësuar të mbulojnë administrimin e procesit të testimit në gjashtë (6) qendra të testimit. Edhe pse me paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet që anëtarët e panelit duhet të reflektojnë përbërjen etnike, varësisht nga etnia e zyrtarit që i nënshtrohet procesit të testimave, vërehet se vetëm njëri prej paneleve ka përmbushur një pjesë të kërkesës ligjore (paneli nr. 3 i angazhuar në qendrën e testimit të kandidatëve tek Universiteti i Shkencave Aplikative në Ferizaj). Përbërja e anëtarëve të paneleve përmbushë kriterin tjetër, sipas të cilit, ata duhet të kenë një gradë më të lartë se zyrtarët që i nënshtrohen procesit të gradimit.</p> <p>1.8. Përkundër deklarimeve të menaxhmentit se heqja e disa kufizimeve në procesin e aplikimit elektronik përmes sistemit PRIMs ka ndodhur për të ofruar mundësi të barabarta në radhët e të interesuarve, IPK nuk ka vërejtur të ketë ndodhur verifikimi i të kaluarës së kandidatëve, për t'u siguruar se ata kanë përmbushur edhe kriterin mbi historikun disiplinor e penal, të paraparë me Udhëzim dhe Shpalljen e konkursit. Po ashtu, IPK ka hasur që në listat e testimit janë përfshirë edhe një numër zyrtarësh policor, të cilëve nuk iu ishte vlerësuar performanca për disa periudha vlerësuese<sup>8</sup>.</p>
--

<sup>5</sup> Shkresa e Drejtorit të DZHPK-së drejtuar Drejtorit të Divizionit për Personel dhe Administratë (datë 05.01.2024)

<sup>6</sup> PK10102, PK10237, PK10254 dhe PK10451.

<sup>7</sup> Referencat e shkresave mbi themelimin e paneleve të testimit me shkrim: DPA-10/006/2024, DPA-10/007/2024, DPA-10/008/2024, DPA-10/009/2024, DPA-10/010/2024 dhe DPA-10/011/2024.

<sup>8</sup> PK7375, PK7368, PK7361, PK4980 dhe PK4779.


Këtë IPK e potencon me faktin se vlerësimi i performancës është fushë e vlerësimit brenda procesit të gradimit.

1.9. Sipas nenit 18 të Udhëzimit, aplikantët që konkurrojnë për ngritje në gradë duhet të përfundojnë me procesin e testimit, ku për gradën rreshter mes tjerash parashihet edhe testi me shkrim. Neni 20 i Udhëzimit përcakton që testi me shkrim hartohet për të testuar njohuritë e zytarit policor në fushën e legjislacionit penal dhe procedural penal, aktet normative e administrative që normojnë veprimtarinë policore, politikat e procedurat e Policisë dhe shkathtësitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimit. Në mars të këtij viti, Policia ka publikuar në intranet, një Listë pyetjesh për procesin e gradimit për rreshter. Bazuar në përmbajtjen e tij, dokumenti përfshinë një gamë fushash, nga të cilat mund të gjenerojnë pyetjet e testit. Ky publikim është bërë transparent me qëllimin e mirë që kandidatët të orientohen në fushat kyçe, drejt përgatitjes cilësore të tyre. Në vazhden e përgatitjes së testit me shkrim, DZHPK ka përgatitur pakon e pyetjeve prej 289 sosh dhe përmes Drejtorit të DBNJ-së ia ka propozuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, i cili më pas edhe i ka aprovuar më 30.04.2024 në formë të Regjistrit, konform nenit 20 të Udhëzimit. Nga regjistri prej 289 pyetjeve, konform nenit 27 të Udhëzimit, Komisioni ka përzgjedhur 100 pyetje të testit me shkrim. Autoriteti përgjegjës ka krijuar dy teste, përmbajtja e të cilave është e njëjtë, vetëm se ka dalluar renditja numerike e pyetjeve, gjë që edhe i ka bërë të dallueshme ato.

1.10. Testimi me shkrim i kandidatëve është realizuar më 04.05.2024, në gjashtë (6) qendra testimi. Lidhur me këtë fazë, kandidatët janë njoftuar me kohë nga DZHPK. Në përjashtim të disa qendrave ku ka pasur vështirësi teknike, në pjesën më të madhe të qendrave, testimi me shkrim ka filluar me kohë. Testimit i janë nënshtruar 1.749 kandidatë nga gjithsej 2.230 sish të përfshirë në Listën e testimit (78.4%). Sipas raporteve zyrtare, në këto qendra janë dhënë 1.749 fletë përgjigje nga shpërndarja e 900 testeve A dhe 849 testeve B, ku këto të fundit i kanë pasur pyetjet e njëjta, por me renditje të ndryshueshme (testi në gjuhën serbe ka qenë A). Janë vërejtur dobësi teknike në plotësimin e formularëve të pranimit - dorëzimit të materialit të testimit nga Komisioni dhe panelet vlerësuese, lidhur me shpërndarjen e testeve dhe numrin e tyre. Është krijuar përshtypja sikur nga radhët e paneleve nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme në aspektin teknik mbi plotësimin e formularëve.

1.11. Kontrolli i testeve ka filluar menjëherë pas testimit me shkrim në të njëjtën ditë dhe është realizuar në DZHPK. Rreth 92% e testeve me shkrim është kontrolluar me skaner, derisa pjesa tjetër prej 8% është kontrolluar në formë manuale për shkaqe teknike. Në 61 teste në gjuhën serbe janë identifikuar gabime të përkthimit, për të cilat, pas procesit të rivlerësimit është vendosur në favor të kandidatëve, konform nenit 21 të Udhëzimit. Më 07.05.2024, lidhur me procesin, të gjitha panelet, por edhe anëtarët e Komisionit kanë përgatitur raportet mbi fazën e testimit sipas qendrave ku janë përfshirë. Publikimi i rezultateve është bërë më 06.05.2024, dy ditë pas testimit me shkrim. Nga Lista e rezultateve të testimit me shkrim prej 1.480 kandidatësh që kanë arritur kuotën prej 70% të pikëve, 283 prej tyre i takojnë gjeneratës së 54-të (19%). Më 14.05.2024, Kryesuesi i Komisionit për këtë proces të gradimit ka nxjerrë një Raport, me të cilin ka njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë lidhur me procesin e testimit me shkrim. Raporti përmban edhe disa rekomandime lidhur me përmirësimin e proceseve të ardhshme të gradimit.

1.12. Krahas publikimit të rezultateve të testit me shkrim nga DZHPK, për vërejtjet dhe pakënaqësitë lidhur me procesin dhe rezultatet e testimit me shkrim, konform nenit 23, paragrafi 3 të Udhëzimit, kandidatët janë udhëzuar mbi të drejtën e tyre në ankesë në afatin prej tre (3) ditë pune, duke filluar nga dita e publikimit të rezultatit. Sipas Raportit të Komisionit, të drejtën e ankimit e kanë shfrytëzuar 25 kandidatë dhe shqyrtimi i ankesave të tyre është bërë brenda afatit ligjor. Po ashtu, në adresë të Komisionit kishin arritur edhe 40 kërkesa të kandidateve për shikimin e testeve, ku sipas Komisionit, të interesuarve u është ofruar qasje, por që këtë të drejtë e ka

	shfrytëzuar vetëm një pjesë e tyre (disa kandidatë edhe pse kanë kërkuar qasje, nuk kanë shfrytëzuar këtë mundësi).
<p><b>Përfundime</b></p> 	<p>Nga gjetjet e këtij inspektimi pasqyrohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Policia e Kosovës ka në fuqi udhëzime dhe procedura standarde të operimit që rregullojnë proceset e gradimit, përfshirë edhe kriteret dhe periudhat e kalimit nga grada në gradë, por që duhet të jetë e harmonizuar edhe me periudhën e realizimit të programit për trajnimin themelor.</li> <li>2. Procesit të gradimit i ka parapri një proces i identifikimit të vendeve të lira për gradën rreshter dhe analiza e nevojave për personel të graduar, duke marrë parasysh mundësitë buxhetore dhe duke iu përmbajtur Strukturës dhe LPA-së.</li> <li>3. Me gjithë faktin se konkursi i shpallur përmban kriterin për qëndrim minimum 5 vjet shërbim në organizatë të kandidatëve që mund t'i nënshtrohen procesit të aplikimit, nuk është përfshirë edhe kriteri tjetër për kandidatët që duhet të kenë qëndrim dy (2) vjeçar në gradën "polic i lartë".</li> <li>4. Ka dobësi në respektimin e afateve në kalimin (lëvizshmërinë) e personelit nga grada kadet deri në gradën polic i lartë, gjë që dëshkohet edhe nga të dhënat në dosjet personale të kandidatëve të gjeneratës 54.</li> <li>5. Përkundër idesë që aplikantëve t'u ofrohet mundësi për aplikim, ka pasur një proces konkurrimi, i përcjellur me disa dobësi në pranimin e aplikacioneve edhe kur kandidatët nuk kanë përmbushur kriteret ligjore të aplikimit, si rezultat i heqjes së masave kufizuese të sistemit elektronik PRIMIS.</li> <li>6. Pjesëmarrja në proces të gradimit i është mundësuar edhe gjeneratës së 54-të, ku sipas dosjeve personale të zyrtarëve policor të kësaj gjenerate vërtetohet se nuk përmbushin kriterin e qëndrimit prej dy (2) vitesh në gradën polic i lartë (brenda listës së aplikimit janë hasur pjesëmarrës me gradë edhe më të ulët).</li> <li>7. Derisa për themelimin e Komisionit janë marrë parasysh kërkesat ligjore rreth numrit të anëtarëve, përbërjen sipas etnisë dhe gradave, në kuadër të vendimeve mbi themelimin e paneleve nuk është respektuar parimi i etnicitetit edhe pse ka pasur kandidatë të etnive tjera në proces. IPK çmon zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit, pas deklarimit të konfliktit të interesit nga disa prej tyre.</li> <li>8. Janë evidentuar raste kur pjesë e Listës së kandidatëve për testimin me shkrim kanë qenë edhe kandidatë, që nuk iu është kryer vlerësimi i plotë i performancës siç parashihet me Udhëzim.</li> <li>9. Procedura e përzgjedhjes së pyetjeve të testeve nga DZHPK, krijimit të regjistrit dhe aprovimit të tij, si dhe hartimi i pyetjeve finale të testeve A dhe B ka ndjekur hapat e duhur. Edhe pse janë identifikuar disa pyetje në testin e gjuhës serbe për shkak të përkthimit jo cilësor, nuk ka pasur ndonjë pasojë në rezultatin final të kandidatëve, meqë gjatë vlerësimit të testeve janë eliminuar pasojat.</li> <li>10. Procesi i mbajtjes së testit me shkrim në qendrat e testimit përgjithësisht është realizuar brenda rregullave dhe afateve, të përcjellur me disa vështirësi teknike që duhet sanuar në procese tjera, përfshirë edhe mungesën e video monitorimit brenda hapësirave të testimit.</li> <li>11. Kontrolli i testeve është realizuar në masë të madhe me metoda të avancuara, por për arsye teknike është vënë në funksion edhe kontrolli manual. Brenda një kohe të shkurtër dhe të arsyeshme është publikuar Lista e rezultateve të testimit me shkrim.</li> <li>12. Meqenëse kandidatët kanë pasur të drejtën e ankimimit lidhur me rezultatet dhe procesin, Komisioni ka shqyrtuar të njëjtat brenda afateve ligjore. Vlerësohet pozitivisht gatishmëria e Komisionit për t'iu ofruar kandidatëve, shikimin e fletë përgjigjeve të tyre kur ata kanë treguar interesim.</li> </ol>



	<p>13. Inspektimi vë në pah se nga kontrolli i dosjes së gradimit dhe trajtimi i ankesave nuk rezulton të ketë prova që dëshmojnë shpërndarjen e paautorizuar të testit tek kandidatët e caktuar dhe favorizimin e kandidatëve të caktuar.</p> <p>14. Rastet e caktuara si rezultat i ankesave të pranuar në IPK janë duke u trajtuar nga Departamenti i Hetimeve të IPK-së, por që për të cilat deri në këtë fazë nuk rezulton të ketë dyshim të arsyeshëm për hetim penal.</p>
--	--

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore <sup>9</sup> (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të rishikojë harmonizimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019 për Procedurën e Gradimit për Zyrtarët Policor, me periudhën e realizimit të trajnimit themelor, duke qartësuar edhe rrugëtimin e personelit nga grada "kadet" deri në gradën "polic i lartë".	-I-	Policia e Kosovës krahas ndryshimit të akteve tjera nënligjore parasheh edhe ndryshimin Udhëzimit Administrativ Nr.02.2019 për procedurën e gradimit për Zyrtarët Policor.	2024
2.	IPK i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës që në të ardhmen gjatë përgatitjes së shpalljeve të konkurseve për këtë gradë, të përfshijë edhe kohën e qëndrimit minimal në gradë në mesin e kriterëve të aplikimit, drejt respektimit të plotë të kërkesave të Udhëzimit.	-I-	Drejtoria për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës që nga shpallja e konkursit për gradën përkatëse dhe jo vetëm, do të respektojë procedurat e parapara sipas Udhëzimit Administrativ.	2024
3.	IPK i rekomandon Drejtorit të Divizionit të Personelit dhe Administratës që të përkujdeset në aspektin administrativ për kalimin me kohë të zyrtarëve policor nga grada kadet deri në gradën polic i lartë, duke respektuar afatet e parapara me Udhëzim.	-I-	Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë do të veprojë në pajtim të plotë me rregullat dhe procedurat e parapara edhe sa i përket kalimit në gradë nga grada Kadet në gradën Polic i Lartë bazuar në Udhëzimin Administrativ.	2024
4.	IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore që të sigurohet se sistemi PRIMS aplikon masat kufizuese për filtrimin e aplikimeve që nuk plotësojnë kriteret për t'iu nënshtruar proceseve të gradimit. Në raste kur aplikimet kryhen në mënyrë fizike, të sigurohet se ndiqen rregullat e aplikimit, përfshirë dhe shqyrtimin dhe verifikimin e historikut disiplinor dhe penal të kandidatëve.	-I-	Drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore do të sigurohet që në koordinim me Drejtorin për Teknologji Informative dhe Komunikim, me rastin e aplikimit përmes sistemit elektronik PRIMS, kandidatit t'i pasqyrohen të dhënat disiplinore dhe ata kandidatë të cilët nuk i plotësojnë kriteret për t'iu nënshtruar procesit të gradimit, të mos kenë të drejtë të vazhdimit të procesit, njëjtë sikur edhe zyrtarët policor, të cilët kanë masë aktive disiplinore. Sa i përket aplikimit fizik, Komisioni mbikëqyrës për procesin e gradimit, do të shqyrtojë të gjitha aplikacionet e të gjithë kandidatëve lidhur me plotësimin e kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ dhe pas përfundimit të procedurave të testimeve, Drejtoria për Zhvillim të Performances dhe Karrierës dërgon	2024

<sup>9</sup> Komentet e strukturës policore janë përmbajtje e tekstit autentik të saj të datës 21.06.2024 dhe në to nuk ka pasur ndërhyrje.

			<i>listën finale të zyrtarëve për gradim në Drejtorinë për Hetime të Brendshme për verifikimin e së kaluarës së tyre disiplinore dhe penale.</i>	
5.	<i>IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore që të sigurohet se në proceset e gradimit respektohet parimi i përfshirjes në panele edhe të anëtarëve nga radhët e komuniteteve tjera etnike.</i>	<i>-I-</i>	<i>Drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore në rastin konkret Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë për themelimin e paneleve vlerësuese në mungesë të anëtarëve nga radhët e komuniteteve, të cilët nuk kanë pasur mundësi të jenë pjesë e panelit në testin me shkrim për arsye shëndetësore apo familjare, prandaj të njëjtët janë zëvendësuar me anëtarë të tjerë dhe këto zëvendësime nuk kanë ndikuar në integritetin e mbarëvajtjes së procesit edhe pse gjithmonë ky kriter është marrë dhe do të merret parasysh edhe në të ardhmen.</i>	<i>2024</i>
6.	<i>IPK i rekomandon Kryesuesit të Komisionit të procesit të gradimit dhe Drejtorit të Drejtorisë për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës që në të ardhmen të sigurohen që kandidatët gjatë aplikimit të kenë të kryer vlerësimin e performancës, si një nga pikat e vlerësimit brenda procesit të gradimit.</i>	<i>-I-</i>	<i>Drejtoria për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës në bashkëpunim me Komisionin përgjegjës të procesit të gradimit, do të sigurohet që kandidatët gjatë aplikimit të kenë të kryer vlerësimet e performancës, ashtu siç kërkohet në Udhëzimin Administrativ.</i>	<i>2024</i>
7.	<i>IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore, Kryesuesit të Komisionit të procesit të gradimit që të sigurohet se anëtarët e paneleve vlerësuese kuptojnë detyrat lidhur me procesin e testimit me shkrim, si dhe kanë njohuri të nevojshme për ploitësimin e evidencave lidhur me materialet e testimit (formularët).</i>	<i>-I-</i>	<i>Drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore, Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë, Drejtoria për Zhvillimin e Performancës dhe Karrierës dhe Komisioni përgjegjës për procesin e gradimit, gjithmonë kanë mbajtur dhe do të mbajnë takime të rregullta sqaruese dhe informuese lidhur me detyrat dhe përgjegjësit e paneleve përkatëse.</i>	<i>2024</i>
8.	<i>IPK i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të ndërmarrë veprime për të evituar çfarëdo dobësie apo lëshimi në këtë proces të gradimit, duke e konsideruar këtë raport si pasqyrues të gjetjeve që mund të kenë dëmtuar kredibilitetin e mbarëvajtjes së procesit në fjalë.</i>	<i>-I-</i>	<i>Polica e Kosovës do të veprojë gjithmonë me ndërgjegje dhe profesionalizëm, me qëllim që secili proces të jetë shembull i organizimit, zhvillimit dhe mbikëqyrjes për një mbarëvajtje sa më të mirë të procesit të gradimit.</i>	<i>2024</i>